



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

Histori e SHBA-së

Ngarkesa: 4 kredite, 20 orë seminare
Viti / Semestri: Viti II, semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor në Gjuhën Angleze
Kodi i etikës: Kodi i Etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: T'u ofrojë studentëve një panoramë të qartë dhe kronologjike të zhvillimeve historike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, nga epoka para-europiane deri në kohët moderne. Të ndihmojë studentët të kuptojnë ngjarjet dhe proceset historike që kanë formësuar shoqërinë, shtetin dhe institucionet amerikane. Të ndërgjegjësojë studentët për ndikimin e historisë në zhvillimet sociale, politike dhe kulturore të SHBA-së dhe marrëdhëniet e saj ndërkombëtare.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të analizojnë dhe interpretojnë ngjarje kyçe si kolonizimi, lufta për pavarësi, lufta civile dhe proceset e industrializimit dhe modernizimit.
2. Të identifikojnë rolin e faktorëve si kultura, gjeografia, ekonomia dhe institucionet në formësimin e historisë amerikane.
3. Të përdorin terminologjinë historike në mënyrë korrekte dhe të aplikojnë burime parësore dhe dytësore në përgatitjen e eseve dhe prezantimeve analitike.

Rezultatet e pritshme :

1. Studentët do të jenë në gjendje të përshkruajnë në mënyrë të saktë periudha dhe ngjarje kyçe të historisë së SHBA-së dhe të analizojnë ndikimin e tyre në zhvillimin e mëvonshëm të vendit.
2. Do të kuptojnë dhe interpretojnë zhvillimet politike, shoqërore dhe ekonomike në kontekst kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë luftën për pavarësi, luftën civile dhe marrëdhëniet globale të SHBA-së.
3. Do të jenë të aftë të përdorin njohuritë e fituara për të zhvilluar qëndrime kritike dhe për të debatuar mbi ndikimin e së kaluarës në sjelljen dhe strukturën e shoqërisë amerikane të sotme.